

## PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN:

**Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve  
ID 7.12/o “Prodhimi i këpucëve”**

**Prodhimi i produkteve plastike  
7.13 “Përveç rasteve të përmendura në veprimtaritë e tipit A ose tipit B të  
kësaj shtojce, prodhimi i produkteve prej plastike”**

*(sipas shtojcës 1 të Ligjit 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar”)*

**SUBJEKTI: “GL.SA”**

**NIPT: L72310010T**

**VENDNDODHJA: Korçe, Barç, Pasuria nr. 261/89, Zona kadastrale  
Nr.1101, Vol.12, Faqe 40**

## 1. PROFILI I KOMPANISE

Subjekti “GL.SA” I regjistruar në QKB me datë 10/11/2017 me nr. NIPT L72310010T.

Aktiviteti i këtij subjekti konsiston në prodhimin e aksesoreve të kepuceve si sholla, goma etj.

Procesi i prodhimit ka baze lenden e pare, e cila vjen nga importi, lekuren dhe gjithë aksesoret e tjera të kepuces me proces perpunimi kimik duke prodhuar shollen me material plastik.

### Subjekti do të aplikojë për leje mjedisi Tip B

#### Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve

#### ID 7.12/o “Prodhimi i këpucëve”

#### Prodhimi i produkteve plastike

#### 7.13 “Përveç rasteve të përmendura në veprimtaritë e tipit A ose tipit B të kësaj shtojce, prodhimi i produkteve prej plastike”

Referuar shtojces 1 të ligjit 52/2020 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10448, DATË 14.7.2011, “PËR LEJET E MJEDISIT”, TË NDRYSHUAR.

## 2. OBJEKTIVAT E AKTIVITETIT:

- ❖ Objektivi i parë i këtij aktiviteti do të jetë të identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore të kësaj instalimi të cilat janë:
  - Emetimet në ajër dhe zhurmat;
  - Ndikimi në flore/faunë;
  - Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti i punetoreve;
  - Ndikime social-ekonomike;
  - Ndikim në cilësinë e jetesës në qendrat e banuara;
  - Ndikim në rritjen e trafikut rrugor;
  - Ndikim në peizazhin e zonës;
  
- ❖ Objektivi i dytë i këtij aktiviteti është gjetja e alternativave që janë më miqësore me mjedisin.

### 3. VENDNDODHJA E AKTIVITETIT

Vendndodhja e aktivitetit është: **Korçe, Barç, Pasuria nr. 261/89, Zona kadastrale Nr.1101, Vol.12, Faqe 40.**



Nr.	X	Y
1.	4482843.24	4500553.63

#### 4. PERSHKRIMI AKTIVITETIT

Aktiviteti i ketij subjekti konsiston ne prodhimin e aksesoreve te kepuceve si sholla, goma etj.

Subjekti ka vendosur makinerite e prodhimit ne nje hapesire te hapur ku sipas procesit jane rradhitur makinerite ne rresht, secila specifike ne pozicionin e saj.

Linja e prodhimit konsiston ne reparte si:

1. Magazina e materialit te lendes e pare
2. Reparti i prerjes dhe stampimit te syprines
3. Reparti i qepjes dhe preses
4. Reparti i montimit (ngjitja, qepja, etj)
5. Paketimi

Procesi i prodhimit ka baze lenden e pare, e cila vjen nga importi, lekuren dhe gjithë aksesoret e tjere te kepuces me process perpunimi kimik duke prodhuar shollen me material plastik.

##### **Fazat kryesore te procesit te prodhimit te syprinave jane:**

**Faza I:** Magazinimi i mallit pasi behet importi nga Italia i materialeve te gatshme te nevojshme per te prodhuar syprina.

**Faza II:** Prerja e lekures (Tranca) dhe perdorimi i granulates per prodhimin e shuallit.

**Faza III:** Pune pergatitore e cila ndahet ne procese skajim me makineri dhe skajim me vijeues ky process behet manualisht me dore.

**Faza IV:** Hedhja ne manovije per qepjen e kepuceve dhe ngjitjen me mastic

**Faza V:** Procesi i kontrollit te cilesise se syprinave te prodhuara si dhe prodhimin te sholles pres plastike dhe paketimi i tyre per eksportim.

##### **Instalimet e perdorura jane:**

1. Kompresor
2. Makina qepese
3. Tranca
4. Skajues
5. Manovij
6. Prese me injeksion
7. Hinke
8. Shrederi i shkrirjes se materialit plastik

### **Materialet qe perdoren:**

- **Ngjyrat, kremerat dhe materialet e pastrimit**

Jane materialet qe perdoren ne fazat e mbarimit te procesit te prodhimit.

Ngjyrat jane me baze dylli.

Kremi ndihmon per te bere kepucet te duken me mire estetikisht duke i dhene shkelqim.

Per pastrimin perdoren detergjente te vecante, te cilet heqin papastertite e depozituara ne kepuce gjate procesit te perpunimit

- **Fillerat** qe perdoren jane nga fibrat prej pambuku ne pjeset ku eshte e mundur, ndersa ne raste qe duhet te jene me rezistente kepucet perdoren fillera prej najloni.

- **Forcuesit**

Forcuesit jane te gjitha elementet te cilet mbeshtesin syprinën. Materialet per forcim duhet te jene te ngurta pse te bute ne varesi te llojit te lekures qe duhet forcuar.

- **Ngjitesit**

Reagentet ose ngjitesat jane ato substanca ose produkte qe kane veti lidhese dhe bashkojne dy siperfaqet.

## **5. IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMIT I SHKARKIMEVE NE MJEDIS**

### **SHKARKIME NE AJER**

- ✓ Sharkime ne ajer konsiderohen aromat e solventeve. Per te shmangur demtimet qe mund te shkaktohen ne aparatit e frymemarjes punonjesit do te pajisen me maska qe sherbejne per mbrojtje e shendetit te tyre.

Gjithashtu nga venia ne pune e pajisjeve te punes emetohen pluhura ne ajer ne ambientet e brendshme te kesaj fabrike, edhe pse keto emetime jane ne nivele te paperfillshme, per te shmangur demtimet qe mund te shkaktohen ne aparatit e frymemarjes se personave qe punojne aty, eshte vendosur sistem ventilimi per kapjen e ketyre pluhurave.

### **SHKARKIME NE UJERA**

- ✓ Proceset e punes qe zhvillon ky aktivitet jane te tilla qe nuk shkaktojne ndotje te ujerave nentokesore dhe as atyre siperfaqesore. Gjate zhvillimit te ketij aktiviteti nuk ka as shkarkime te lendeve ndotese ne uje. Ujerat sanitare te pastrimit te personelit shkarkohen ne rrjetin e kanalizimeve te zones.

### **SHKARKIME NE TOKE**

- ✓ Aktiviteti nuk shoqerohet me sharkime ne toke. Aktiviteti nuk gjeneron mbetje te ngurta qe te demtojne mjedisin. Ne proceset teknologjike te prodhimit te shollave te kepuceve te ndryshme, gjenerohen sasi te vogla mbetje gomash dhe shollash, te cilat nuk depozitohen ne mjedis por do te trajtohen nga operatore te licensuar me te cilet subjekti ka lidhur kontrate.

### **ZHURMA DHE VIBRIME**

- ✓ Zhurmat qe prodhohen vijne kryesisht gjate procesit te prodhimit. Proceset e prodhimit shoqerohen me clirim zhurme, por nuk vleresohen ne nivele shqetesuese per zonen, vetem per ambientet e punes. Per kete operatori eshte kujdesur qe punonjesve t'u siguroje veshje mbrojtese.

### **MBETJE**

- ✓ Aktiviteti nuk gjeneron mbetje te ngurta qe te demtojne mjedisin. Ne proceset teknologjike te prodhimit te shollave, gomave te kepuceve te ndryshme, gjenerohen sasi te vogla mbetje gomash dhe shollash, te cilat nuk depozitohen ne mjedis por do te trajtohen nga operatore te licensuar me te cilet subjekti ka lidhur kontrate. Gjithashtu mund te gjenerohen dhe mbetje nga paktimi, te cilat nuk jaen te demshme per mjedisin.
- ✓ Ndersa mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti i punonjesve, ne fund te cdo dite pune do te transportohen ne kontenieret e percaktuar nga Njesia Vendore.

### **NDIKIME NE FLORE DHE FAUNE**

- ✓ Zona ne te cilen ushtrohet aktiviteti eshte nje zone ne te cilen nuk takohen elemente te spikatur te flores dhe faunes. Perreth kesaj zone mund te hasim bimesi te ulet dhe barishte. Aspekti faunistik paraqet nje larmi biologjike te varfer. Zhvillimi I ketij aktiviteti nuk paraqet asnje ndikim negativ ne flore apo faune.

### **NDIKIM SOCIAL-EKONOMIK**

- ✓ Me operimin e ketij aktiviteti pritet te kete nje impakt pozitiv ne ekonomine e qytetit ku zhvillohet aktiviteti. Operatori do te punesoje personel te zones, duke bere te mundur rritjen e nivelit ekonomik dhe te punesimit.

**SUBJEKTI**  
**“GL.SA”**

**Administrator**  
**Simone Sgariglia**